



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*  
*Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice*  
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions  
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.20/2023

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.988/18, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese nga dhe Përmbaruesi Privat, me datë 13.11.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-20/2023 i datës 24.08.2023, si dhe ankesa e palës ankuese nga Prishtina, e datës 17.08.2023, si të pabazuara.

**II.** Përmbaruesi Privat Eset Murati si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.988/18.

### A r s y e t i m

Pala ankuese, nga me datë 17.08.2023, ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat pasi sipas ankesës, përmbaruesi privat ka bërë shkelje për lëndën në fjalë, sepse me veprimet e tij të papërgjegjshme e për përfitime vetnake, duke mos njoftuar debitorin ka bërë kërkesën për bllokim të llogarive në Sipas palës ankuese, të njëjtit, nuk i janë dorëzuar shkresat asnjëherë dhe pasi të ishin dorëzuar shkresat do parashtronte prapësim ashtu që pas vendimit të gjykatës do vazhdohej me procedurën. Pala mëtej pretendon se nuk i është dhënë rasti për prapësim dhe nga ky shkak edhe ndihet i dëmtuar. I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe ndaj përmbaruesit të ndermirren masa adekuate dhe të obligohet përmbaruesi të tërheq urdhrin e tij dhe procedura të nis nga fillimi.

Me datën 24.08.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin për Përfundimtar, ndaj përmbarruesit privat, lidhur me veprimet përmbarrimore për këtë rast, të cilin raport e kanë prezantuar edhe në seancën dëgjimore, duke mbetur në tërësi pranë ankesës së ushtruar nga pala ankuese.

Përmbarruesi Privat, në seancën dëgjimore ka theksuar se bllokimi i llogarisë është bërë konform dispozitave të LPP-së.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbarruesi privat, kanë ngulur pranë pretendimeve ankimore, deklarimeve në seancë dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbarruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi pretendimin e palës ankuese se a është bllokuar llogaria sipas procedurave dhe gjeti se pala ankuese ka parashtruar prapësim dhe pas vendosjes së gjykatës lidhur me prapësimin është bërë tërheqja e mjeteve. Për këto arsye komisioni vlerëson se përmbarruesi privat nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet e masave disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbarrimore për rastin të cilin është paraqitur ankesa janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazën e të dhëna si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARRUESIT PRIVAT

DPL.nr. 20/2023 datë 13.11.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi

*M. Karaçi*

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

